



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i dosjes:** KSC-BC-2020-07

**Vendos:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 29 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial dhe *ex parte*

---

## Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake

---

**Gjykatësi i Procedurës Paraprake:**

Gjykatës Nikola Giju

**Zyra e Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në pajtim me nenet 32(3), 33(1)(a) dhe 38(4) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullat 85(1) dhe 86(1) dhe (2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktim”), cakton gjykatësin për të kryer funksionet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 tetor 2020, Prokurori i Specializuar e njoftoi Kryetaren në pajtim me rregullën 86(1) të Rregullores për procedurat që do të iniciohen në pajtim me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(2) të Rregullores, dhe kërkoi caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në pajtim me nenin 33(1)(a) të Ligjit.

## II. CAKTIMI

2. Kryetarja e cakton Gjykatësin e Procedurës Paraprake, pasi të ketë konsideruar kriteret e përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullës për Caktim, sidomos përvojën dhe ekspertizën përkatëse, si dhe disponueshmërinë në këtë moment.

## III. KLASIFIKIMI

3. Njoftimi është përcjellë konfidencialisht dhe *ex parte* dhe vendimi aktual do të ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet si publike në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktim.

**PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA ÇAKTON**

**Gjykatësin Nikola Giju**

si Gjykatës të Procedurës Paraprake në çështjen aktuale.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,  
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E enjte, 29 tetor 2020  
Në Hagë,  
Holandë